

GJL. Nr. 506/2012

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dep.	DPK / DMP
Nr. i fag. Broj. stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-1724/2012
Enlla Datum Date	11.05.2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë
nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Nadire Vitija nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 37292/11 të dt. 27.03.2012, në bazë të nenit 31, 33, 39 konform të nenit 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 24.04.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e paraqitur si e pabazuar
VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. regj. 37292/11 të dt. 27.03.2012, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.
Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr. regj. 37292/11 të dt. 27.03.2012, të pandehurën Nadire Vitija nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjëse sepse: si Drejtoresh menaxhuese në Bordin e Termokosit-Ngrohtorja e qytetit në Prishtinë, e emëruar më dt. 28.06.2011, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë në afatin e caktuar ligjor prej 60 ditëve, pranë Agjencionit kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë e njoftuar se është përfshirë në listën e Zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë me rastin e zgjedhjes së tyre në funksione udhëheqëse, me ç,veprim e pandehura ka kryer kundërvajtje nga neni 7 pika 1 lidhur me nenin 16 par. 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe është dënuar me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) Euro.

Me të njëjtin aktvendimi e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi e pandehura Nadire Vitija, ka paraqitur ankesë, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe dënimit për kundërvajtje, me arsyetim se: E kontestoj atë se në seancën e rishqyrtimit jam dëgjuar si përgjegjëse e kundërvajtjes dhe jam ballafaquar me sekretarin e ndërmarrjes Termokos z. Nexmedin Beha, në bazë të aktvendimit në fjalë kuptoj se është dëgjuar edhe përfaqësuesi i agjencionit antikorruption z. Agron Bajrami, në fazën e ballafaqimit me z. Beha i njëjti përsëri si më parë ka dëshmuar të pavërtetën. Duke shtuar se në takimin e parë të Termokosit është dashur të njoftohen drejtorat e bordit për obligimet ndaj AKK-së, me rastin e emërimit në këtë pozitë. Këtë e vërteton edhe e-maili im reagim për mos njoftim dhe kërkesë për takim urgjent të Bordit po më dt. 27.10.2011, menjëherë kam deklaruar pasurinë pranë AKK-së (provë materiale vërtetimi i lëshuar nga AKK-a) duke i propozuar Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, ta aprovoj në tërësi këtë ankesë ndërsa aktvendimin e Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim.

Kolegji i kësaj gjykate duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur është e pabazuar, ashtu që aktvendimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

2.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të deklaratës së dhënë të pandehurës Nadire Vitija, në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt. 22.11.2011, e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se: është e vërtetë se unë nuk e kam bërë deklarin e pasurisë në afatin e caktuar nga se nuk kam qenë e njoftuar se jam e obliguar që ta bëjë këtë; deklarimit të dëshmitarit Nexmedin Beha zyrtar kontaktues me Agjencionin kundër korrupsionit në procesverbal të dt. 14.12.2011, i cili thekson se në mbledhje të bordit në të cilën ka qenë edhe z. Nadire Vitija e kam njoftuar bordin e drejtorëve për obligimin e tyre për deklarin e pasurisë; deklarimit të dëshmitarit Agron Behrami shef divizioni në Agjencion Antikorrupsion në Prishtinë, me Autorizim të dt. 28.02.2012, nr. 01. në procesverbal të dt. 29.02.2012, i cili në deklaratën e tij e vërteton kundërvajtjen me të cilën ngarkohet e pandehura; Procesverbalit mbi ballafaqimin të dt. 29.02.2012, në mes të pandehurës Nadire Vitija dhe dëshmitarit Nexhmedin Beha i cili gjatë ballafaqimit sy me sy i tha të pandehurës se është e vërtetë se në mbledhjen e bordit jeni njoftuar për deklarin e pasurisë pranë AKK-së gjë që e pandehura e kundërshtoi; shkresës zyrtare të Termokosit të dt. 26.08.2011-komunikim i zyrtarit kontaktues me agjencionin-sipas të cilës konstatohet se drejtorët e bordit të Termokosit në mes tyre edhe Nadire Vitija, janë të njoftuar për obligimin e deklarimit të pasurisë në afat prej 60 ditësh pas marrjes së postit; por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës pa dyshim se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar gjendjen faktike se e pandehura ka kryer vepër të përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të goditur, për të cilën mbanë përgjegjësi kundërvajtëse, andaj nuk ka bazë për anulimin ose rishqyrtimin e aktvendimit të goditur siç ka propozuar e pandehura në ankesën e paraqitur.

Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse, nuk ka bërë shkelje të dispozitave kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse gjoha e shqiptuar në shumë prej 500 (pesëqindë) Euro, ndaj të pandehurës Nadire Vitija, konform të nenit 7 të LK. konsiderohet se është caktuar dhe përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, peshës së veprës së kryer si dhe rrethanave nën të cilat është kryer vepra, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për ndryshimin apo abrogimin e aktvendimit të goditur dhe konform të nenit 220 të LMK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.


GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJL. Nr. 506/2012 të dt. 24.04.2012

SEK. JURIDIKE

Nexhmije Abazxhik

[Signature]



KRYETARJA E KOLEGJIT,

Mejreme Zekaj

[Signature]